LIGJ
Nr. 15/2014

PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT NR. 1 TË MARRËVESHJES SË KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË E PËRFAQËSOHET NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT MBARËKOMBËTAR TË RADIOTERAPISË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet dokumenti i ndryshimit nr. 1 i marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë e përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG, për financimin e projektit mbarëkombëtar të radioterapisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.2.2014

Shpallur me dekretin nr. 8510, datë 6.3.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

UniCredit
Corporate and Investment Banking

LETËR PRANIMI
Ne kemi marrë nga ju ofertën e mëposhtme:

UniCredit Bank Austria AG
8243/Export Finance
Gerd E. ROSE
Schottengasse 6-8
A-1010 Vienna
Tel. +43 (0) 505 05 /50326
Faks. +43 (0) 505 05 /56943
E-mail: gerd.rose@unicreditgroup.at

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë

Për dijeni: Ministrisë së Financave
Në vëmendje të: Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
SHQIPËRI
Me DHL Ref. Tonë: Ref. Tuaj
25 maj 2013

Lënda: Huaja e Butë për Marrëveshjen e Kredisë së Eksportit nr. 232.653 për një shumë prej 2, 000 000 eurosh, të datës 25 prill 2013 në lidhje me financimin e Projektit të Radioterapisë Pan-Kombëtare

Ndryshimi nr. 1

Të nderuar zotërinj,

Banka dhe Huamarrësi kanë lidhur më 25 prill 2013 Marrëveshjen e Kredisë në shumën prej 2,000.000,00 eurosh për financimin e Projektit të Radioterapisë Pan-Kombëtare.

Ne kemi kënaqësinë t'ju informojmë se termat dhe kushtet e mëposhtme më tërheqëse do të zbatohen për Marrëveshjen e mësipërme të Kredisë. Kështu, modifikimet e mëposhtme, të specifikuara në këtë ndryshim nr. 1, bëhen pjesë përbërëse e Huas së Butë për Marrëveshjen e Kredisë së Eksportit nr. 232.653 për një shumë prej 2, 000 000 eurosh, të datës 25 prill 2013 në lidhje me financimin e Projektit të Radioterapisë Pan-Kombëtare.

Faqe 21, aneksi 3, neni 9

"Shlyerja do të bëhet deri në 19 (nëntëmbëdhjetë) këste të njëpasnjëshme gjysmëvjetore të barabarta, i pari bëhet i kërkueshëm 72 muaj pas Datës së Pranimit të Përkohshëm, në çdo rast jo më vonë se data 31 korrik 2020."

Faqe 22, aneksi 4, neni (b)

"(iii) lista e paketimit në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje."

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit mbeten të pandryshuara dhe të vlefshme.

Ky ndryshim nr. 1 nënshkruhet në 2 origjinale dhe hyn në fuqi me marrjen nga Banka të siglimit të ndryshimit nr. 1 nga Huamarrësi.

Për Huadhënësin:
UniCredit Bank Austria AG

(Nënshkrimi)	*(Nënshkrimi)*
Reinhard Riedl	Gerd Rose
Menaxher i Lartë	Menaxher i Lartë

të cilën në këtë mënyrë e pranojmë plotësisht në kohën e duhur.

Për Huamarrësin:
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë
dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave.